



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 29 maj 2019, në mbledhjen e XIII-të (trembëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.25’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu, përveç anëtares Fatlume Jaha e cila mungoi,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishte i pranishëm, z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës,

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesi i OSBE-së z.Veton Vehapi, si dhe përfaqësuesi i Rrjetit të OJQ-ve, Rexhep Zeka.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, shtoi, thirrjen materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, ndërkohë është paraqitur edhe një pikë shtesë si propozim për përfshirje në kuadër të rendit të propozuar të ditës. Fjala është për dy propozim Rregullorë të cilat janë paraqitur për vënie në diskutim publik. Për më shumë fjalën e ka kërkuar z.Nexhmi Rudari, Nënkyetari i Komunës, i cili në emër të dy Drejtorëve të Drejtorive përkatëse do të na informoj më në detaje, ngase z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, dhe z.Faik Muçiqi, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, mungojnë me arsye sepse janë zyrtarisht në Prevallë në një punëtori.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, siç e ceku edhe Kryesuesi i Kuvendit, Drejtorët e dy Drejtorive përkatëse janë në Prevallë në një punëtori që ka të bëjë me Hartën Zonale të Komunës, dhe meqë unë jam i përfshirë në Grupin punues për hartimin ose plotësim ndryshimin e dy Rregulloreve në fjalë, të njëjtat po i paraqes.

Ne si Grup punues kemi punuar në këto dy drafte, dhe t’ju them të drejtën nuk kemi pritur që në këtë periudhë do të kemi dokumentet e gatshme por megjithatë, duke marrë parasysh periudhën e pushimeve verore që kryesisht është në muajin gusht, ne kemi arrit të finalizojmë dy draftet e para të dy rregulloreve të cilat janë shumë të rëndësishme për Komunën e Podujevës, fjala është për Rregulloren për mbrojtjen e mjedisit dhe Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, dokumente të cilat kuptohet që tani duhet t’i nënshtrohen procesit të diskutimit/debatit publik, andaj ajo që kërkohet sot nga anëtarët e KPF-së është që ta mbështetni përfshirjen e kësaj pike shtesë së bashku me këto dy dokumente, në kuadër të rendit të ditës dhe të njëjtën ta rekomandoni për mbledhjen e Kuvendit, konkretisht të ipet pëlqimi që këto dy dokumente të vëhen në diskutim publik, dhe që pas periudhës së diskutimit publik

por edhe gjatë asaj periudhe, si Kuvend dhe si Ekzekutiv do të kemi mundësi të japim kontribut rreth çështjeve që kanë të bëjnë me këto dy dokumente, qoftë propozime, sugjerime apo edhe vërejtje eventuale, në mënyrë që me rastin e shqyrtimit final dhe miratimit, dokumentet final të jenë sa më të kompletuara. Andaj nëse ju e shihni të arsyeshme që për shkak të afateve ligjore këto dy dokumente të vëhen në diskutim publik, do të ishte mirë të përfshihen në rend të ditës, si pikë shtesë, dhe njëkohësisht t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Jam i vetëdijshëm që këto dy dokumente mund të kenë gabime, qoftë gjuhësorë ose teknike, por substanca është kjo që keni para vetës, mirëpo Kuvendi është ai që pastaj e shqyrton më në detaje, shembull, tek vënia e tarifave ose gjobave, Kuvendi është ai që vendos rreth shumave, edhe pse nuk kemi futur asgjë të re nga ato që parashihen me ligje, madje si modele kemi shikuar edhe disa dokumente të tilla të Komunave të ndryshme të Kosovës.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, përkrahim propozimin për përfshirje të kësaj pike në kuadër të rendit të ditës, përkatësisht vënien në diskutim publik të dy draft rregulloreve përkatëse, dhe sigurisht që në mbledhjen e Kuvendit do të japim kontributin tonë, ngase mendoj se janë dokumente mjaft të rëndësishme për Komunën e Podujevës.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, sa i përket kohës – datave kur ne kemi paraparë të mbahet diskutimi publik respektivisht debatet publike për këto dy draftet, nëse Kuvendi mbështetë, janë, diskutimi publik të jetë 30 ditë, nga 03.06.2019 deri më 03.07.2019, për të dy draft rregulloret, kurse sa i përket debateve publike, kemi paraparë që;

- Për propozim Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës, debati publik me qytetarë të mbahet më 17.06.2019 në ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërsa,

- Për propozim Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës, debati publik me qytetarë të mbahet më 18.06.2019, po ashtu në ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

Pra kjo është ajo që ne kemi menduar, kurse mbetet e Kuvendit të vendos.

z.Fitim Haziri, theksoi, dëgjova me vëmendje Nënkryetarin e Komunës i cili paraqiti propozimin për përfshirje të dy draft rregulloreve në kuadër të rendit të ditës. Meqë nuk është diçka që është finale, por vetëm kemi të bëjmë me vënie në diskutim publik, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim që të futet në rend të ditës dhe njëkohësisht t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim. Shpresoj që pas kësaj periudhe, të gjitha propozimet e qytetarëve të merren parasysh.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështesim të përfshihet në rend të ditës kjo pikë shtesë së bashku me dy draftet në fjalë, për arsye se nëse nuk ka Rregullore nuk ka se si të veprohet në fusha përkatëse ngase organet përkatëse duhet të kenë bazë në ndonjë dokument.

Do të ishte mirë që sa më shpejt të jetë e mundur të miratohen këto dy Rregullore dhe të vëhen në funksion, kështu që ne i mbështesim të futen në rend të ditës, të rekomandohen për shqyrtim në Kuvend dhe të vëhen në diskutim dhe debat publik, natyrisht duke mbajtur të drejtën që gjatë kësaj periudhe por edhe gjatë shqyrtimit final në Kuvend të japim propozime, sugjerim për plotësim ndryshime eventuale.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, në fakt Komuna e Podujevës ka të miratuar në vitin 2015 Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, e cila ende është në fuqi, por që e cila është e tejkaluar, do të thotë tani kemi kaluar në një fazë tjetër ku parashihen tarifa, gjoba dhe inkasimi si çështje kryesore që ne si Komunë mendojmë që inkasimi të bëhet nga Komuna. Kjo për shkak se për mos kryerje të punëve, Operatori përkatës vazhdimisht ankohet për shkallë të ulët të inkasimit, andaj nëse ne si Komunë marrim përsipër inkasimin ashtu siç e ka marrë Prishtina dhe Prizreni, atëherë do të kemi mundësi që qoftë bizneset apo edhe amvisëritë t'i kushtëzojmë, gjithnjë në kuadër të ligjeve, jo jashtë tyre. Pra janë disa shërbime në kuadër të administratës komunale të cila mund të kushtëzohen me pagesën e faturave të mbeturinave.

z.Fitim Haziri, theksoi, rreth kontraktimit të Kompanive si është menduar të bëhet, a kontraktohen nga Komuna apo si do të rregullohet kjo çështje.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përgjigje parafolësit, theksoi, Kompania për menaxhimin e mbeturinave është Kompani Publike Regjionale "Pastrimi", ndërsa për pjesën tjetër që kemi të bëjmë me Kompani private, Komuna duhet të hyjë në kontratë me atë, do të thotë duhet të vëhet në baza ligjore çdo gjë, konkretisht duhet të veprohet me thirrje të hapur publike, lloj tenderi, ku aplikohet, dhe nëse e njëjta aplikon me kushte më të mira se sa konkurrentët e tjerë, mund të fitoj dhe të nënshkruhet kontratë.

z.Fitim Haziri, theksoi, mendoj se është mirë t'i bëhet një vlerësim Kompanisë "Pastrimi" në mënyrë që të shikohet kapaciteti i saj se sa mund të ofroj shërbime.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përgjigje parafolësit, një gjë të tillë e kam sqaruar edhe në një prej mbledhjeve të Kuvendit, do të thotë që ne kemi qenë paksa të shtyrë prej GIZ që është donatori kryesor, por edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilat kanë bërë presion të madh që Kompania private të hiqet tërësisht ngase askund në Kosovë nuk ka kompani private për menaxhimin e mbeturinave, por ne për shkak edhe të vlerësimit të kapaciteteve të Kompanisë "Pastrimi" që kemi vlerësuar se nuk i kanë të plota për kryerjen e të gjitha punëve ashtu siç kërkohet, ne kemi dhënë mundësi që në një pjesë të territorit të Komunës së Podujevës të funksionoj edhe kompania përkatëse private, mirëpo tani ajo kompani duhet t'i nënshtrohet procedurave ligjore.

z.Fitim Haziri, theksoi, sa jam në dijeni Komuna e Prizrenit dhe Komuna e Fushë Kosovës, kanë kompani private për menaxhimin e mbeturinave.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përgjigje, është e vërtetë që dy Komunitat e cekura nga parafolësi kanë kompani private për menaxhimin e mbeturinave, por kanë tjetër sistem. Edhe në Kuvend e kam cekur se për mbrojtje të ambientit dhe mbrojtje të mjedisit do të ketë donacione të mëdha, dhe në këtë kontekst, donatorët qoftë nga jashtë qoftë të brendshëm nuk japin donacione për kompani private që janë profitabile, por japin për kompani publike të cilat janë shtetërore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, ende nuk kemi hyrë në rend të ditës përkatësisht ende nuk është miratuar rendi i propozuar i ditës, por meqë sqarimet dhe detajet rreth propozimit të pikës përkatëse shtesë ishin të nevojshme, paksa u zgjatë kjo pikë, andaj të mos bëhet temë tani por mund të diskutohet sipas radhës nëse veç hynë në rend të ditës.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u mbështet përfshirja në rend të ditës për këtë mbledhje (në pikën 4);

➤ **Propozim Vendim për vënie në diskutim publik:**

- **Propozim Rregullorë për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës**
- **Propozim Rregullorë për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës**

Njëkohësisht u mbështetën edhe datat e diskutimit dhe debateve publike si dhe kohës së mbajtjes, sipas propozimit të bërë nga Nënkyetari i Komunës.

Kryesuesi, e hedh rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar, duke përfshirë edhe pikën shtesë të mbështetur paraprakisht.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar, duke përfshirë edhe pikën shtesë e cila paraprakisht u mbështet njëzëri nga anëtarët e KPF-së.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 07 maj 2019

Njëzëri, pa vërejtje u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 07 maj 2019.

2. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, lidhur me punimet në rrugën “Zahir Pajaziti”

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, informata në fjalë është përgatitur ashtu siç është kërkuar në mbledhjen e kaluar të Kuvendit dhe e njëjta ju është përcjellë me kohë të gjithëve.

Siç u njoftuat edhe paraprakisht, Drejtori i DPUMM, nuk ka mund të jetë prezent sot në këtë mbledhje për shkak të pjesëmarrjes në një punëtori në Prevallë, por në mbledhjen e Kuvendit sigurisht që do të jetë prezent dhe do të jep sqarime dhe përgjigje tjera shtesë varësisht të kërkesave që mund të jenë.

z.Avni Fetahu, theksoi, është mirë që kjo informatë është sjellë me kohë dhe konform kërkesës së një këshilltari të Kuvendit, andaj si të tillë në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e rekomandojmë për diskutim në mbledhjen e Kuvendit, ku edhe sigurisht që do të japim kontributin.

z.Fitim Haziri, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit të Komunës që kjo informatë të diskutohet. Sigurisht që rreth kësaj teme kemi vërejtje dhe sugjerime andaj për më shumë do t'i paraqesim në seancë të Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për diskutim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

3. Rishqyrtimi i Vendimit me nr.prot.01-060/01-0030178/19

-Shkresa e Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal, nr.pro.020-253/8

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht që të gjithë keni marrë shkresën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL, dhe keni parë se si është vlerësuar vendim i cekur, fjala është për vendimin sipas të cilit KEDS-it i ndalohet vendosja e orëve elektrik në shtylla elektrike në territorin e Komunës së Podujevës. Besoj të gjithë jemi në dijeni rreth procesit të këtij vendimi, i cili është ashtu siç është e rregulluar me legjislacion është dërguar në MAPL për shqyrtim administrativ të ligjshmërisë përkatësisht për vlerësim të ligjshmërisë së aktit, vlerësim i cili është kthyer dhe si të tillë e keni para vetës, konkretisht keni vërejtur se çfarë ka konstatuar MAPL.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së sigurisht që i rekomandojmë Kuvendit për rishqyrtim të vendimit në fjalë, vendim për të cilin po shpresoj që ndoshta juristët mund të na qesin në binarë në seancën e Kuvendit sepse në një formë edhe neve na është koklavitur kjo çështje dhe na ka vënë në situata të pa lakmueshme rreth asaj që, a është dashtë të merren Kuvendet e Komunave me çështje të kësaj natyre. Kështu që në Kuvend do të diskutojmë dhe pasi të shterën debatet mund të shohim edhe sugjerimet e dhëna nga MAPL, dhe sugjerimet tjera që dalin nga diskutimi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim, në shkresën e MAPL-së, nuk bëhet fjalë për sugjerime por kemi të bëjmë me vlerësim të ligjshmërisë së aktit në fjalë të miratuar në Kuvendin e Komunës, ku në mënyrë decitive thuhet se akti në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, pra kemi të bëjmë me konstatim të MAPL-së.

z.Fitim Haziri, theksoi, desha të kyçem rreth asaj që kemi parë në dokumentin e MAPL-së e që besoj se të njëjtin e kemi të gjithë. Për ne është shqetësuese qysh MAPL për shqyrtimin e një vendimi merr kaq kohë të gjatë, kurse në bazë të ligjit është 30 ditë për të shqyrtuar një lëndë, kurse ky shqyrtim ka tejkaluar edhe ligjin për shqyrtimin e lëndës kur merret një vendim. Gjëja tjetër është ajo që MAPL ka konstatuar se vendimi është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, do të thotë se me këtë përshkrim i jep komplet kuptim që është në kundërshtim, mirëpo në arsyetimin e MAPL-së ku ceken dispozitat ligjore me të cilat akti në fjalë është në kundërshtim, thuhet, vendimi i Komunës nuk ka cekur

bazën ligjore mbi të cilën mbështetet dhe arsyetohet, fjala është tek neni 2, e që ne i kemi dhënë arsyetimet tona, konkretisht kemi thënë se KEDS është duke i shkelur të drejtat elementare të njeriut që janë siguria dhe transparenca. Pastaj në fund të shkresës së MAPL-së thuhet, bazuar në të cekurat më lartë, MAPL kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e Komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditëve, do të thotë ka kërkuar që të ceket baza ligjore rreth nenin 2 të vendimit. Unë nuk jam jurist me profesion, mirëpo me marrjen e këtij vlerësimi unë e kam kontaktuar një jurist dhe kemi analizuar së bashku këtë çështje dhe kemi nxjerrë bazën ligjore për krejt ato që ne e bazojmë nenin 2 të vendimit, pa ndryshuar asgjë në vendim përveç duke ia shtuar bazën ligjore, nga Kushtetuat e Republikës së Kosovës, ZRRE, OSSH dhe të gjitha të tjerat. Unë tani do t'jua shpërndaj nga një raport të cilin e kemi përpiluar me juristin, raport të cilin mund ta shikoni dhe analizoni. Çështje tjetër që dua të cek ka të bëjë me atë që siç e di unë zyra ligjore është në dispozicion të Kuvendit dhe asamblistëve, unë me marrjen e materialit konkretisht përgjigjen e MAPL-së kam kërkuar prej zyrtarit përkatës që të këshillohem lidhur me vlerësimin e MAPL-së, por zyrtari në fjalë më ka thënë që ne si zyrë kemi të bëjmë vetëm me vendimet që merren në Kuvend por jo edhe për këshillime me asamblistë sa i përket ligjshmërisë apo jo, besoj që zyra e Kuvendit është në shërbim të çdo paqartësie që kemi ne, që të diskutojmë për çdo vendim sepse ne nuk jemi juristë dhe për ata është edhe zyra përkatëse.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, KEDS-i si operator që është nuk ka sistem të operimit të njëjtë në tërë Kosovën, shembull, në disa Komuna janë vendosur në shtylla poshtë, në disa komuna tjera nuk lejohet as inkasimi, në disa nuk lejohen të hiqen as nga ekonomitë familjare sepse janë orët me blloba.

Edhe në Komunën tonë kemi laramani sa i përket vendosjes së orëve për matjen e shpenzimit të energjisë elektrike ku ka vende që janë nëpër ekonomi familjare, ka vende ku janë në shtylla elektrike qoftë poshtë, qoftë tani lartë në shtylla me këto investimet e fundit që janë duke ndodhur, madje unë qysh sot pash që në fshatin Peran janë duke vendosur orë elektrike lartë në shtylla. Mendoj që mos e drejta për qasje në shpenzime është shkelje e të drejtave të konsumatorit dhe këtë çështje e rregullon mjaft mirë legjislacioni përkatës dhe s'ka diskutim për këtë çështje. Në një formë ne si Kuvend jemi në pozitë jo të mirë sepse nuk kemi komunikim me KEDS por as nuk kemi informata rreth investimeve në këtë fushë. Për mos vendosjen e orëve lartë në shtylla dhe për mos qasje në shpenzime të energjisë në fakt ne të gjithë kemi qenë kundër dhe ekzistojnë edhe deklaratat tona sa i përket kësaj çështje. Pastaj tek çështja e vendosjes së transformatorëve në lokacione të ndryshme e kemi mbështetur ne si subjekt politikë i PDK-së për shkak të përmirësimit të rrjetit dhe energjisë në përgjithësi.

Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, Ministrinë dhe instancat më të larta nganjëherë verdikte të tilla dinë t'i lënë me dykuptimësi, do të thotë nuk marrin vendime të prera dhe në mënyra urdhëruese, dhe në këtë aspekt unë pash vlerësimin i cili paksa është i koklavitur, përkatësisht në një vend thuhet duhet të ndalet, kurse në vendin tjetër thuhet duhet të harmonizohet.

Marrja e vendimit për këtë temë i takon Komunës, Kuvendit të Komunës së bashku me Ekzekutivin e Komunës, e them këtë sepse është një temë e cila na prek të gjithëve, qoftë në institucione, qoftë në familje, qoftë qytetarët, kështu që unë duke mos dashur dhe duke ditë se komunikimi drejtpërsëdrejti është Kryetar Komune - KEDS (përfaqësuesi), mendoj se do të ishte mirë të bëhej një harmonizim i përbashkët në mënyrë që të mos bartet kjo çështje në adresa të caktuara, por të jetë vendim i Kuvendit të Komunës, përkatësisht të përgatitet një draft i përbashkët në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të merret vendim, kurse Ekzekutivi pastaj do të ishte i lirë pastaj prej atyre çështjeve sepse vetëm do t'i angazhonte inspektorët, kurse për çështje tjera rreth orëve, mirëmbajtjes së tyre janë procedura tjera dhe organe tjera që merren me atë çështje. Pastaj as në zyra të KEDS-it po të shkoj konsumatori nuk po iu lejohej ta shikonte shpenzimin, çështje kjo e cila është jashtë çdo norme, qofshin edhe norma humaniste ato, e që as në shtetin e Kores nuk ndodhin, kështu që unë jam kundër vendosjes së atyre orëve lartë në

shtylla për arsye askush nuk mund të shikoj orën e tij se sa ka bërë shpenzime, por vetëm të paguhen fatura të cilat janë pothuajse fiktive. Vendimi ekziston dhe përgjigja është se çfarë duhet të bëhet, kështu që ne e diskutojmë këtë çështje edhe njëherë në mbledhjen e Kuvendit, por mund ta diskutojnë edhe Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike brenda për brenda tyre, pastaj këtë çështje mund ta diskutoj edhe njëherë Ekzekutivi i Komunës, mirëpo deri sa ne të marrim një vendim, KEDS do të vazhdoj të vendos orë elektrike lartë në shtylla e që edhe inspektorët komunalë e kanë të pamundshme të kryejnë punën e tyre sepse nuk kanë vendim për ndërprerjen e punëve.

Pra ne ose duhet t'i lejojmë KEDS-in të vendos orët lartë në shtylla, ose duhet t'i ndalim, e që mendoj se njëanshëm asnjë Grup politikë nuk mund të merr një vendim të tillë, pa dashur të jem popullsitë mendoj se duhet të jemi unanimit rreth kësaj çështje dhe të japim një përgjigje lehtësuese për të gjithë, edhe pse në mënyrë gjenerale e kemi një përgjigje nga ana e MAPL-së.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se përgjigja në mënyrë gjenerale është se akti në fjalë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Ndërsa sa i përket asaj pjesës së fundit të shkresës së MAPL-së, ne duhet të gjejmë dispozitë konkrete të saktë ligjore që mund të mbështetet vendimi.

z.Avni Fetahu, theksoi, rreth asaj që Kryesuesi e tha, shtrohet pyetja se a mund të gjejmë dispozitë ligjore konkrete në mënyrë që të ri marrim një vendim të tillë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për korrektësi ju them se kemi hulumtuar dhe jemi konsultuar me legjislacion mirëpo deri tani nuk kemi arrite të gjejmë dispozita konkrete në ndonjë ligj që ne si Kuvend të mund të marrim vendim të tillë.

z.Fitim Haziri, theksoi, nëse keni vullnetin dhe jeni të interesuar, mund ta lexoni raportin që jua shpërndava dhe mund të gjeni dispozita ligjore ku mbështetet vendimi.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, i nderuar Kryesues, në fakt edhe pasi që ju ta ri shqyrtoni vendimin në fjalë dhe pasi të merrni një vendim të ri, sërish ai vendim do t'i nënshtrohet shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së apo ndonjë Ministrie tjetër relevante, andaj mendoj se si Kuvend duhet të jeni të kujdesshëm në marrjen e vendimit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është fakt se edhe po që se marrim vendim të ri në mbledhjen e Kuvendit, e që duhet të marrim sepse kemi të bëjmë me rishqyrtim të aktit, konsideroj se ne duhet të kemi kujdes sepse nuk na tolerohet të gabojmë dy herë radhazi për një vendim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po ta shikojmë në procesverbal se çfarë kam thënë në atë seancë kur është marrë ai vendim shohim se unë e kam thënë që kur një subjekt politik, cilido qoftë ai, përgatit një propozim dhe kërkon të merret vendim në Kuvend, ai dokument duhet të përgatitet në përputhje me legjislacionin në fuqi, pse e them këtë, sepse tani veç po hyjmë në periudhën e pushimeve verore dhe mund të shkojnë edhe nja 2 muaj deri të kthehet vlerësimi i dytë i ligjshmërisë së vendimit që ne do ta marrim lidhur me këtë çështje, madje po që se është në kundërshtim me legjislacion nuk e shqyrtojnë fare ngase dy shqyrtime për një akt të njëjtë nuk ka arsye. Pra ne nuk jemi ata të cilët direkt ia japin fjalën e fundit një akti të Kuvendit, dhe nëse ne sërish e plotësojmë me këto pikat që i prezantoj z.Haziri, sërish duhet të dërgohet në Ministri më për vlerësim të ligjshmërisë.

Rreth çështjes në fjalë, po të isha kompetent menjëherë do të urdhëroja inspektorët të bëjnë ndërprerjen e vendosjes së orëve lartë në shtylla sepse do të mbështeteshin në atë se nuk mund të bënë askush asgjë në Komunën time diçka çka nuk bënë në Komuna tjera apo në shtet të tyre, mirëpo kjo kompetencë është e Kryetarit të Komunës.

Pra dokumentin në fjalë dikush duhet ta merr dhe ta përgatit në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht këtë draft dikush duhet ta merr përsipër që të harmonizoj me legjislacion, pastaj mbështetjen time do ta keni për ndërprerjen e vendosjes së orëve lartë në shtylla nga ana e KEDS.

z.Avni Fetahu, theksoi, ashtu siç e kam analizuar këtë çështje, qoftë në rrafshin praktik qoftë sa i përket legjislacionit, jam interesuar edhe në nivel lokal edhe në atë qendror, kam shkuar edhe në KEDS dhe kam marrë disa informata, jam konsultuar në dy vendbanime me banorë, njëri vendbanim përkatësisht në fshatin Batllavë, më kanë thënë se prej vendosjes së njehsorëve lartë në shtylla kemi nga 3-4 € më pak shpenzime në fatura, andaj është mirë ta shikojmë edhe në rrafshin praktik këtë çështje, e jo të thirremi vetëm në një deklaram të një asamblisti të Kuvendit i cili fol për fshatin Shajkoc, dhe ta marrim vetëm atë parasysh. Madje në Fshatin ku unë jetoj janë duke vendosur shtyllat dhe me padurim po e pres vendosjen e njehsorëve lartë në shtylla në mënyrë që të shikoj gjendjen faktike sa i përket shpenzimeve. Pra të bëhemi real në rrafshin praktik, për që nuk është keqpërdorur rryma nga një pjesë e qytetarëve, nuk mund të themi se jo, andaj mendoj se ndoshta do të ishte mirë të bëjmë edhe ne vet analiza praktike, shembull, ta marrim një vendbanim, të analizojmë faturat para se të vendosen njehsorët lartë në shtylla, dhe t'i krahasojmë ato me periudhën pas vendosjes së njehsorëve lartë në shtylla, pastaj mund të njoftohemi më saktësisht rreth kësaj çështjeje. Përndryshe neve si këshilltarë të Kuvendit nuk na takon të ndikohemi nga disa njerëz të cilët deklarojnë gjëra të ndryshme.

Sa i përket rrafshin legjislativ, definitivisht është paksa problem ngase vërtetë shkresa e MAPL-së ka dykuptimësi, njëherë thuhet se nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, pastaj thuhet të harmonizohet akti në fjalë, dhe tani vërtetë duhet të gjejmë një jurist përnjëmend dhe ta shikojmë se mund të harmonizohet apo jo.

Sa i përket dokumentit që u shpërnda nga z.Fitim Haziri, e shikova shpejt e shpejt sa ishit duke diskutuar, vërtetë theksohen disa çështje në vija të trasha siç është transparenca etj, por në rrafshin praktik është problem paksa të gjendet vendi i atyre pikave që ceken në dokument, dhe këtë juristët e dinë më mirë.

z.Fitim Haziri, theksoi, sa më kujtohet, në fillim të mandatit është sjellë një shkresë nga MAPL-së që ka pas të bëjë me Rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale, shkresë sipas të cilës në rregulloren në fjalë kanë qenë 3-4 pika të jashtëligjshme, dhe pastaj ne unanimisht kemi votuar që ato pika të përmirësohen në bazë të këshillave të MAPL-së, e njëjta gjë është edhe tek ky vendim që jemi duke diskutuar.

Sa i përket asaj që parafolësi e tha se kemi rënë në ndikim të një personi, nuk qëndron ajo i nderuar z.Fetahu, madje jemi në dijeni shumë mirë se në fshatin Llapashticë banorët kanë dalë dhe kanë protestuar për një gjë të tillë sa që pastaj me polici janë vendosur njehsorët në shtylla lart, madje madje ata banorë edhe vet e potencojnë se sa kanë qenë të vendosur njehsorët poshtë në shtylla kemi pas faturime më të ulëta se sa tani që janë lartë në shtylla, mirëpo ka edhe të atillë që potencojnë se qëndron e kundërta sa i përket faturimeve. Andaj pyes, a është e drejtë që të vendoset njehsori lartë në shtyllë dhe konsumatorë të mos dijnë se çfarë po bëhet, gjë e cila me legjislacion dhe me Kushtetutë të Republikës së Kosovës është e ndaluar sepse është e drejtë e njeriut, konkretisht unë nuk dëshiroj të blej diçka pa e ditur çka kam harxhuar.

Lidhur me këtë çështje, unë kam bërë një kërkesë edhe tek Avokati i Popullit i cili sa jam në dijeni është në hulumtim të kësaj çështje, dhe shpresoj se shumë shpejt do të marrim një përgjigje, madje para seancës së Kuvendit, çështje e cila ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut, e që sigurisht do ta kemi më të qartë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar zotëri Haziri, duhet ta gjeni dispozitën konkrete që ka të bëjë me ligjin për energji elektrike në Kosovë, dhe pikën 2 të vendimit ta harmonizoni me atë ligj, gjë për të cilën kemi kërkesë edhe nga ana e Ministrisë. Pra kjo çështje është shumë e qartë, MAPL ka thënë se vendimi duhet të nxirret në përputhje me ligjin e aplikueshëm për energji elektrike në Kosovë.

Pra parafolësi e tha se ka shkelje të drejtave të njeriut, mirëpo ju duhet ta gjeni në ligjin për energjinë atë që e thoni, dhe ta futni në dokument dhe e shqyrtojmë, por ai dokument duhet të dërgohet te Kryesuesi i

Kuvendit dhe tek zyra ligjore që të analizohet dhe pastaj të sjellët në Kuvend për shqyrtim e pastaj të vendosim a do të miratohet apo jo.

z.Fitim Haziri, theksoi, pikërisht për këtë çështje që e ceku parafolësi, unë e paraqita dhe jua shpërndava dokumentin-raportin përkatës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, për nga përvoja që kam mund të them se ekziston edhe Udhëzimi Administrativ përkatës i cili për raste të tilla kur ka dilema rreth një akti sa i përket ligjshmërisë, kompetencave etj, Kuvendi mund të bëjë edhe konsultime paraprake me Ministrinë e linjës, kjo për shkak të shmangies së gabimeve ngase në fund të vitit bëhen edhe vlerësimi performancës së kuvendeve të komunave andaj nuk është gjë e mirë të kemi vendime të anuluar. Madje lidhur me këtë, ne në mandatin e kaluar kemi qenë shumë vigjilent në këtë aspekt, për çka i falënderoj edhe dy zyrtarët e zyrës ligjore sepse gjithnjë kanë qenë të kujdesshëm në këtë aspekt.

Lidhur me çështjen konkrete, mendoj se duhet të merren ekspertët ngase as Ministrinë nuk kanë mund t'i japin përgjigje definitive, andaj do të ishte mirë të bëheshin konsultime paraprake me Ministrinë përkatëse në mënyrë që eventualisht të mos marrin edhe njëherë ndonjë vendim të paligjshëm sepse nuk do të ishte diçka e mirë për ne.

Kryesuesi, kërkon nga anëtarët që nëse mund ta merr fjalën përfaqësuesi nga zyra ligjore.

Përfaqësuesi i zyrës ligjore, theksoi, lidhur me çështjen në fjalë, ne si zyrë nuk kemi qëndruar indiferent, kemi hulumtuar dhe jemi angazhuar rreth çështjes së ligjshmërisë së aktit në fjalë, mirëpo problemi qëndron në atë se klauzola kryesore në dokumentin e MAPL-së rreth vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit përkatës, thuhet se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, do të thotë si dispozitiv i vendimit ka këtë vlerësim në rend të parë, ndërsa pjesa e fundit ku thuhet se duhet të harmonizohet, pothuajse praktikohet e njëjta në X dokumente të Ministrisë. Pra kjo çështje është paksa problematike, madje ne kemi kontaktuar edhe përmes telefonit me zyrtar të Ministrisë dhe na është thënë se askund nuk kemi mund të gjejmë dispozitë ligjore që do të mbështetej vendimi në fjalë.

Sa i përket asaj që u tha rreth rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, ju sqaroj se ajo rregullore ka qenë në harmoni me ligjin por zbatimi i saj është kushtëzuar me rekomandime të Ministrisë përkatëse, konkretisht është kërkuar ndryshimi i 2-3 nënpikave të cilat më shumë kanë qenë teknike.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë dëshiroj t'ju informoj se nga momenti që kemi marrë vlerësimin e ligjshmërisë nga MAPL, kemi shikuar dhe analizuar ligjin për energji elektrike në mënyrë që të gjejmë dispozitën konkrete për ta harmonizuar vendimin e cekur, por nuk kemi hasë në ndonjë dispozitë e cila shprehimisht e rregullon këtë çështje.

z.Fitim Haziri, theksoi, është fakt që thuhet se vendimi në fjalë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, mirëpo më poshtë kur shpjegohet se cila dispozita, ceket neni 2 i vendimit të Kuvendit, që është shkelje e të drejtave të njeriut, pra thuhet që vetëm nuk e keni cekë bazën ligjore, do të thotë vendimi i Komunës nuk ka cekë bazën ligjore mbi të cilin do mbështet dhe arsyetohet vendimi në fjalë, pra po thuhet që ne nuk kemi cekë ligjet që e japin arsyetimin rreth kësaj vendimi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të jemi të qartë, propozim vendimi i juaji si subjekt LVV që e keni paraqitur, nuk ka qenë i mbështetur në aspektin ligjor, andaj po dëshiroj të them diçka, luteni të gjithë që para se të dalim me ndonjë propozim vendim pikë së pari të harmonizohet saktë dhe konkret mirë e mirë me bazë ligjore dhe mos të dalim qesharak pastaj me vendime të jashtëligjshme se nuk është e mirë për Kuvendin një gjë e tillë sepse aq sa dalim të hutuar ne, del edhe opinionin pastaj.

Kur e them këtë e kam parasysh se kjo temë është bërë temë e qytetarisë, e mediave dhe informimit publik, madje deri në atë situatë ka shkuar sa që unë jam quajtur edhe manipulues e që nuk keni pasë të drejtë dhe nuk keni pas arsye për një akuzë të tillë sepse është paksa e rëndë. Pra mos t'i japim konotacione të tilla por të veprojmë sipas gjërave të cilat vërtetë janë të bazuara dhe të kryejmë detyrat për çka jemi të thirrur si anëtar të Kuvendit dhe që duhet të kontribuojmë.

z.Fitim Haziri, theksoi, është e drejtë e imja si këshilltar i Kuvendit të Komunës që në bazë të asaj që është sjellë si përgjigje lidhur me vendimin në fjalë, ashtu edhe siç është cekë në rend të ditës ku thuhet rishqyrtim, andaj ne do ta rishqyrtojmë dhe do ta propozojmë bazën ligjore rreth këtij vendimi.

Në momentin që unë kam marrë përgjigjen nga ju Kryesues i Kuvendit, kam kontaktuar zyrtarin përkatës të zyrës ligjore dhe kam pyetur se çfarë mund të bëjmë në këtë drejtim.

Sqarim i zyrtarit të zyrës ligjore, është e vërtetë që jam kontaktuar nga parafolësi, fillimisht pyetja e vetme ka qenë, a duhet sërish ky vendim të dal në Kuvend për votim, përgjigja ime ka qenë po gjithqysh, sepse proceduralisht është e rregulluar kështu, njëherë është shqyrtuar dhe është marrë vendim, kurse tani pas vlerësimit të ligjshmërisë i njëjti duhet të rishqyrtohet, gjë e cila është kundërshtuar nga parafolësi duke u mbështetur në një konsultim me një jurist, konkretisht ka thënë se vendimi në fjalë nuk duhet të del sërish në Kuvend për votim por vetëm duhet të plotësohet dhe gjithçka pastaj është në rregull. Unë edhe njëherë i kam sqaruar këtë, por sërish ka insistuar në atë, duke cekë edhe disa nene dhe dispozita, dhe pastaj i kam thënë që gjëra të tilla nuk mund të thuhën tani për tani po ose jo, siç po kërkohet përmes telefonit sepse duhet të analizohen më në detaje dhe kërkohet hulumtim.

z.Fitim Haziri, theksoi, i nderuar Kryesues, e keni sjellë si pikë të rendit të ditës për rishqyrtim dhe ne do ta rishqyrtojmë dhe do ta propozojmë edhe bazën ligjore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, po i nderuar është përfshirë në rend dite për rishqyrtim sepse ashtu kërkohet me dispozita ligjore dhe nënligjore ngase bëhet fjalë për të njëjtin organ që ka marrë vendim, mirëpo vlerësimi i ligjshmërisë është bërë nga dikush tjetër që është MAPL e cila ndër të tjera ka rekomanduar rishqyrtimin e vendimit ngase është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

z.Fitim Haziri, theksoi, atëherë në rregull, meqë është për rishqyrtim, ne do t'ia bashkëngjisim bazën ligjore atij vendimi, nga Kushtetuta e deri në aktet tjera përkatëse dhe do ta propozojmë në Kuvend.

Sa i përket çështjes së manipulimit që u cek nga Kryesuesi, unë e kam thirr Kryesuesin në mënyrë njerëzore dhe i kam thënë që i nderuar Kryesues mos e nënshkruani vendimin sepse është njëri prej asamblistëve i cili nuk ka votuar fare, Kryesuesi më ka thënë në telefon se janë numëruar të gjitha votat dhe është vendos njëherë ajo çështje dhe unë nuk manipuloj me këtë punë, andaj nëse bëhet fjalë për manipulim pikërisht ky është manipulim që ju nuk keni numëruar votat ashtu siç duhet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, meqë po dëshiron të lëshohem në detaje, ai votim ka qenë i hapur, janë numëruar votat publikisht, me zë, dhe nuk ka pasur asnjë reagim dhe asnjë kundërshtim. Nëse e marrim me paragjykime atë situatë, mund të ndodh që dikush e ngritë dorën shpejt dhe pastaj e ulë por që ajo votë mund të jetë numëruar, andaj nuk mund të merret videoja përkatëse që ju e keni paraqitur, si fakt absolut, ngase nuk është tërësisht e sqaruar votimi në atë video, mos mendoni, nuk kemi dashtë të shkojmë më në detaje, por e kam nënshkruar vendimin ashtu siç ka konstatuar MAPL sipas ankesës tuaj që keni bërë, andaj mos e merrni ju që keni pas plotësisht të drejtë, ngase ajo situatë mund të shikohet edhe në aspekte tjera sepse mund të ketë raste kur ngritët dora dhe menjëherë ulet por numërohet, në të kundërtën secili për votën e vetë mund të deklarohet aty për aty, votova, nuk votova, ose mund të tregoj si voton, por jo pas disa ditësh të dilet me deklarata.

Pra asnjëherë nuk e kundërshtoj anën ligjore që në këtë rast ka qenë një shkresë e Ministrisë, por të thuhet se Kryesuesi ka manipuluar, është gjë e cila tek unë nuk ka vend.

z.Fitim Haziri, theksoi, është asamblisti i subjektit tuaj ai vet i cili e ka pohuar në media se nuk ka votuar fare, andaj nuk ka dëshmi më të mirë se kjo.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje parafolësit, pikërisht ajo ka qenë njëra prej arsyeve që nuk e kam kontestuar sugjerimin e Ministrisë, por e kam nënshkruar atë vendim, sepse është nivel qendrorë dhe mbikëqyrës për funksionimin e Komunave, andaj edhe këtë shkresë që kemi tani lidhur me vendimin në fjalë duhet ta respektojmë sipas sugjerimeve të tyre, se ka qenë apo nuk ka qenë i bazuar në ligj, po të ishte mirë nuk do të vinte fare deri tek kjo situatë.

z.Fitim Haziri, theksoi, këto gjëra që Kryesuesi po i thot ndoshta e ka paska edhe nga mllefi se si ka shkuar deri te ky vendim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje, një gjë jua them, për çështje të tilla asnjëherë mos paragjykoni ashtu, unë totalisht jam i liruar nga paragjykimet, andaj provo ta praktikosh edhe ti.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, me qëllim që të dilet nga kjo temë, edhe në përgjigjet që japin Ministrinë për vendime tjera të Kuvendit të Komunës, po edhe të vendimeve të Kuvendeve të Komunave tjera, përafërsisht është i njëjti shabllon ku Ministria jep vlerësim dhe pastaj jepet një arsyetim dhe kështu krijon konfuzion. Shumë mirë e tha z.Rafet Llapashtica, mos pritni diçka nga MAPL-ja që mund të nxjerrë vendime siç janë vendimet e Gjykatave ta zëmë, të prera, do të thotë vendimet i nxjerrë me dykuptimësi, edhe të jep të drejtë edhe nuk të jep të drejtë. Mendoj se e juaja si Kuvend, dhe e Kryesuesit të Kuvendit është që të siguroj bazën ligjore për këtë vendim të propozuar, nëse sigurohet sakt baza ligjore dhe të jeni të sigurt që çdo gjë është në rregull, Kuvendi mund të merr vendimin në fjalë dhe i njëjti sërish dërgohet në Ministri për vlerësim të ligjshmërisë ku pastaj ose miratohet ose hudhet poshtë, nëse ndodh të hudhet poshtë si i paligjshëm, atëherë nuk do të ishte mirë për Kuvendin e Komunës sepse do të nënkuptohej që Kuvendi i Komunës së Podujevës nuk ka kapacitete të mjaftueshme ligjore për tu marrë me një çështje kaq të thjeshtë, duke pas parasysh që ka qindra çështje tjera të cilat janë më të ndërlikuara. Pra sugjeroj të siguroheni mirë që çfarëdo që merrni të jetë në baza ligjore.

z.Fitim Haziri, theksoi, mendoj se shumë lehtë do të dilnim nga ky debat sikur të ishte një gatishmëri e bashkëpunimit, analizimit dhe shqyrtimit të asaj që e paraqita, sepse nuk e kamë përgatitur vetë atë raport, por është juristi që e ka përgatitur.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, ne si Komunë nuk jemi në dispozicion të shqyrtojmë vendimet e MAPL-së sepse është instancë më e lartë dhe janë vendime të tyre, por mund të shqyrtojmë dhe rishqyrtojmë vendimet tona. Po nuk do të thotë kjo që edhe pse është instancë më e lartë e kanë në rregull, apriori mund të thotë, por nuk do të thotë se është në rregull, mirëpo megjithatë janë instancë administrative më e lartë se ne. Andaj edhe njëherë e them që ju sigurohuni dhe gjejeni mbështetjen ligjore, me nen, me pikë, dhe demantojani atë që Ministria e ka thënë.

z.Fitim Haziri, theksoi, atë që e tha Nënkyetari jemi munduar ta bëjmë, nëse është gatishmëria në rregull nëse jo vazhdojmë, nuk kem çfarë të bëjmë.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, konsideroj se secili këshilltarë i cili voton ka gatishmëri dhe dëshirë që ato vendime të jenë të ligjshme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, debati rreth kësaj pike u stërgjatë paska por qëllimi ishte që të sqarohemi sa më në detaje, andaj e hedh në votim që t'i rekomandohet kuvendit për rishqyrtim të kësaj pike sipas materialit përkatës.

Njëzëri i rekomandohet për rishqyrtim të Vendimit me nr.prot. 01-016/01-0030178, sipas Shkresës së Ministrisë së Administrimit të pushtetit Lokal nr.prot. 020-253/8

4. Propozim Vendimi për vëni në diskutim publik:

- ***Propozim Rregullore për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës***
- ***Propozim Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës***

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë e cila hyri si pikë shtesë në rend të ditës, besoj se u sqaruam në fillim të kësaj mbledhje dhe u japën arsyetimet e nevojshme, andaj nëse keni diçka për të shtuar, urdhëroni nëse jo e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit të prezantuar, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e diskutimit publik dhe debateve publike që u cekën nga Nënkryetari i Komunës në fillim të kësaj mbledhje.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me propozim që:

*-Për propozim Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës, diskutimi publik zgjat 30 ditë përkatësisht prej nga **03.06. 2019** deri më **03.07.2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më **17.06.2019** në orën **10:00**.*

*-Për propozim Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës zgjat 30 ditë përkatësisht prej **03.06.2019** deri më **03.07.2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më **18.06.2019** në orën **10:00**,*

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0043095/19

Podujevë,

29 maj 2019

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi